REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:139164
Datë: 27.03.2023
Numri i dokumentit: 04126722

**C.nr. 485/2018**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**, **Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil,** gjyqtari **Berkan Hamza,** me bashkëpunëtor profesional **Samir Morina,** në çështjen juridiko – kontestimore të paditësi H. H. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëso av. D. M. nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës S. B. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, me vendbanim në Zvicër – adresë e panjohur, me bazë juridike – zgjidhja e martesës, jashtë seance, me datë **27.03.2023**, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET E TËRHEQUR** padia me numër **C.nr.485/2018** e paditësit H. H. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës S. B. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, me vendbanim në Zvicër – adresë e panjohur, me bazë juridike – zgjidhja e martesës.

**A r s y e t i m**

Paditësi H. H. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëso av. D. M. nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, më datë 27.12.2018, ka iniciuar procedura juridike - kontestimore përmes padisë kundër të paditurës S. B. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, me vendbanim në Zvicër – adresë e panjohur, me bazë juridike – zgjidhja e martesës.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit av. D. M. nga Prizreni, në gjykatë më datë 23.09.2021, ka dorëzuar parashtesën me anë të së cilës ka informuar gjykatën se "*pala nuk ka interes për vazhdimin e procedurës dhe mbi ketë bazë në mungesë të interesit juridik për vazhdimin e kësaj çështje, e bënë tërheqjen e padisë"*.

Meqenëse në gjykatë është paraqitur një situatë e re në lidhje me ketë çështje juridik, atëherë e njëjta ka vepruar sipas nenit 261 par. 1 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), ku është paraparë se: *"Paditësi mund ta tërheq padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi...",* mbi bazë të kësaj norme juridike gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në harmoni të plotë me nenin 387 par. 1 pika c) e cila përcakton se "*Me qëllim që çështja të përgatitet sa më mirë për t'u zgjidhur shpejt e drejt, gjykata që nga momenti i arritjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor të çështjes me aktvendim vendosë për: c) tërheqjen e padisë*".

2019:139165

Prandaj, meqë gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë, në kuptim të dispozitave nga neni 261 par. 1 si dhe me 387 par. 1 pika c) të LPK-së, për çka ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,**
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil,**
**C.nr. 485/2018, më datë 27.03.2023.**

**Bashkëpunëtor profesional** **Gj y q t a r i**
**Samir Morina** **Berkan Hamza**

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.